



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## Raport për tremujorin e parë 2021

Oda e Mjekëve të Kosovës



Prill 2021

Prishtinë

## **Përmbajtja:**

Raport për tremujorin e parë 2021 .....	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi .....	3
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale .....	5
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	6
5. Licencimet.....	6
6. Edukimi specialistik - zberthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të .....	7
7. Këshilli Mbikëqyrës .....	7
8. Komisioni për çështje Etike i OMK-së .....	7
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke .....	7
10. Raporti financiar.....	8
10.1 Gjendja financiare – 31 mars 2021.....	8
10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional .....	8
10.3 Prokurimi .....	9
11. Aktivitete të tjera.....	9
11.1 Shërbimi profesional.....	9
11.2 Botimi i Revistës “Mjeku” .....	9
11.3 Ndarja e Dekoratave dhe e Mirënjohjeve të OMK-së.....	9
11.4 Draftimi i aktit normativ për kompenzimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor që humbin jetën në krye të detyrës .....	10
11.5 Hulumtim/Pyetësor rreth vaksinimit të mjekëve.....	10
11.6 Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	11
11.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike .....	11
12. Plani i veprimit për vitin 2021 .....	12

## 1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore janar–mars 2021, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime si dhe në 3 raste kanë votuar në mënyrë elektronike përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas kërkesave/a nkesave të pranuar për periudhën TM1	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM1	Vendimet për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Këshilli Drejtues i Odës</b>	3	2	1	1- Vendim - Miratohet kërkesa e redaksisë së Revistës që emri i revistës të jetë “Revista Mjeku”; 2- Vendim për publikimin e njoftimit për rekrutim të zyrtarit/-es administrativ/-e; 3- Vendim – Themelohet komisioni Ad-Hoc për dhënien e dekoratave nga OMK; 4- Vendim për publikimin e njoftimit për rekrutimin e gazetarit/-es për Revistë të OMK-së njëkohësisht zyrtar për marrëdhënie me publikun; 5- Rregullorja për e brendshme për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të OMK-së; 6- Vendim për angazhimin e dy (2) praktikantëve;	1

## 2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës janar-mars 2021, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 126 mjekë, nga të cilët janë përfshirë 9 mjekë të punësuar në sektorin publik, 8 mjekë të punësuar në sektorin privat dhe 109 mjekë të papunë.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën janar-mars 2021




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 mars 2021

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 6 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 15 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri më datën 31 mars është 4564 mjekë.

### 3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelore do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM1	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM1	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
<b>Prokurori i Odës</b>	13	3	///	///	15	25
<b>Këshilli Etik</b>	14	18	Rekomandime kolegjiale 0 Qortim Publik 1 Gjoha: 2 gjoha nga 3000 € Gjithsej: 0 00.00€	Qortim publik 0 (00.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithsej: 00.00€ Shpenzime te paushallit: 100€	8	6
<b>Gjyqi i Nderit</b>	3	4	1.)Refuzohet ankesa GJN 08/2020 e Dr. Shukri Gërxhaliut ndaj Vendimit të Këshillit Etik KE 19-8/2020. 2.) Aprovohet ankesa GJN 11/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE KE 12.41-1/2020. 3.)Hidhet si e palejueshme ankesa e Dr. Drilon Zekaj ndaj vendimit të Këshillit Etik KE 22-10/2020 4.) Aprovohet kërkesa GJN 02/2021 e kryetarit të Këshillit Etik	///	2	2


Certifikatat e të kaluarës etike	38	///	///	///	///	///
----------------------------------	----	-----	-----	-----	-----	-----

Në shqyrtime të drejtpërdrejta janë mbajtur gjithsej dy (2) takime të Gjyqit të Nderit për shqyrtimin e këtyre lëndëve.

**Vërejtje:** Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është e pamundur që të nxirret në total bilanci i lëndëve për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.


#### **4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional**

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës janar-mars 2021 ka akredituar 36 aktivitete.



#### **5. Licencimet**

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës janar-mars 2021 ka organizuar 3 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 200 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



## **6. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të**

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

## **7. Këshilli Mbikëqyrës**

Në periudhën kohore janar–mars 2021, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur një (1) takim, ku i kanë shqyrtuar Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të fundit të OMK-së.

## **8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së**

Në periudhën kohore janar–mars 2021, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar shtatë (7) kërkesa për leje për hulumtim.

Gjashtë kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim, ndërsa një kërkesë nuk është aprovuar për shkak të mospërmbushjes së kriterëve.

Komisioni për Çështje Etike, gjithashtu ka nxjerrë vendim për miratimin edhe të një raporti si rezultat i implementimit të hulumtimit.

## **9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke**

Në periudhën kohore janar–mars 2021, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar një (1) kërkesë për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim aprovues lidhur me kërkesën e pranuar.

## **10. Raporti financiar**

### **10.1 Gjendja financiare – 31 mars 2021**

<b>1.0 Të hyrat:</b>		
1.0.1 Të hyrat e shtyra nga 2020		€ 475,907
<b>Të hyrat e shtyra nga 2020</b>		<b>€ 475,907</b>
<b>1.1 Të hyrat</b>	<b>Realizimi: TM1</b>	<b>TOTAL TM1</b>
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 264,512	€ 264,512
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jokosovarë	€ 2,000	€ 2,000
1.1.4 Licencimi	€ 9,700	€ 9,700
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 8,366	€ 8,366
<b>Të hyrat nga TM1</b>	<b>€ 284,578</b>	<b>€ 284,578</b>
<b>Të hyrat e shtyra nga 2020</b>		<b>€ 475,907</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>		<b>€ 760,485</b>
<b>2.0 SHPENZIMET</b>	<b>Shpenzimet: TM1</b>	<b>TOTAL TM1</b>
2.1 Paga, mëditje dhe kontribute pensionale	€ 28,328	€ 28,328
2.1.2 Llogari të pagueshme - Paga, mëditje dhe kontribute pensionale	€ 12,268	€ 12,268
2.2 Material shpenzues	€ 4,923	€ 4,923
2.3 Reprerentacioni	€ 642	€ 642
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 2,000	€ 2,000
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 8,793	€ 8,793
2.6 Shpenzimet e aseteve		€ -
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,000	€ 8,000
<b>TOTAL SHPENZIMET</b>	<b>€ 64,954</b>	<b>€ 64,954</b>
<b>BILANCI TM1-2021</b>	<b>€ 219,624</b>	<b>€ 219,624</b>
<b>TOTAL BILANCI TM1-2021</b>		<b>€ 695,531</b>

1.1.5\* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, kongreset, simpoziumet, seminarët, konferencat vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, certifikatat për të kaluarën etike, lejimi për hulumtime biomjekësore për anëtarë të Odës, të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), dhurata/donacione, të ardhura të tjera.

2.5 \*Faksimili, anëtarësimi në CPME, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të TI-së, shpenzime bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, inventari, shpenzimet e tjera operative.

2.7\*Tek përkrahja për solidaritetet përveç mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

### **10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional**

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës janar-mars ka dhënë përkrahje financiare për Shoqatën e Kirurgëve Plastik, Rekonstruktiv dhe Estetik të Kosovës në vlerë prej 2,000.00 €



### **10.3 Prokurimi**

Gjatë periudhës kohore janar-mars 2021 u zhvilluan dy procedura të prokurimit për vlera të vogla. Si rezultat i këtyre procedurave të prokurimit u bë furnizimi i OMK-së me dekorata/pllaketa për mjekët që kanë dalë në pension dhe për institucionet që kanë kontribuar në luftën kundër virusit COVID-19, si dhe u bë furnizimi i OMK-së me medalje përkujtimore.

## **11. Aktivitete të tjera**

### **11.1 Shërbimi profesional**

Gjatë periudhës janar–mars është bërë përzgjedhja për kandidatët e suksesshëm për pozitën Zyrtar/-e Administrativ/-e pranë Komisioneve të Përhershme dhe Zyrtar/-e për Marrëdhënie me Publikun pranë OMK-së/Gazetare në Revistën e OMK-së sipas konkursit publik të datës 26 janar 2021 dhe 12 shkurt 2021.

### **11.2 Botimi i Revistës “Mjeku”**

Me datë 30 mars 2021, në ditën ndërkombëtare të mjekëve, OMK-ja bëri botimin e Revistës Mjeku. Kjo revistë botohet për herë të parë në Kosovë, e cila trajton aktualitete të ndryshme nga mjekësia kosovare dhe më gjerë. Tema bosht e këtij numri të parë të revistës është COVID-19. Gjithashtu, janë trajtuar edhe tematika të tjera relevante.

Revista Mjeku vjen si rezultat i vizionit dhe angazhimit të Odës së Mjekëve të Kosovës për një revistë informative që i dedikohet mjekut Kosovar dhe lexuesve tjerë potencialë të interesuar në aktualitetet e Shëndetësisë Kosovare. Këshilli Redaktues është i përbërë nga anëtarë të cilët i bashkon bagazhi i madh profesional dhe akademik, por edhe sensi i detyrimit për ta bërë gjithnjë një “hap tutje” në shëndetësinë tonë. Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

### **11.3 Ndarja e Dekoratave dhe e Mirënjohjeve të OMK-së**

Gjatë këtij tremujori Oda e Mjekëve të Kosovës ka ndarë mirënjohje dhe dekorata për mjekët në pension në shenjë falënderimi për kontributin e tyre jetësor gjatë karrierës së tyre dhe për institucionet shëndetësore që kanë kontribuar në luftën kundër COVID-19. Dekorata Nderi i Mjekut “Ali Sokoli” është ndarë në nderim të mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19. Dekorata për arritje shkencore “Musa Haxhiu” është ndarë për mjekun Dr. Flamur Blakaj. Medalje përkujtimore janë ndarë në nderim të mjekëve të cilët

kanë ndërruar jetë përgjatë viteve 2019-2021. Me mirënjohjen e OMK-së gjithashtu janë nderuar mjekët të cilët kanë dalë në pension përgjatë vitit 2020.

#### **11.4 Draftimi i aktit normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve të tjerë shëndetësorë që humbin jetën në krye të detyrës**

Si rrjedhojë e situatës me pandeminë COVID-19, ku një numër i konsiderueshëm i mjekëve dhe punëtorëve të tjerë shëndetësorë kanë humbur jetën në shërbim të pacientëve si rezultat i infektimit me COVID-19, dhe të cilët duke qenë mbajtës të familjes apo kryefamiljarë me vdekjen e tyre kanë rrezikuar drejtpërdrejtë mirëqenien e anëtarëve të familjarëve të tyre. Andaj me datë 12 janar, Oda e Mjekëve të Kosovës ka bërë kërkesë drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, për iniciimin e procedurave për draftimin e aktit normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësorë që humbin jetën në krye të detyrës.

Pas kërkesës së bërë nga Oda e Mjekëve të Kosovës drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, kjo e fundit ka formuar komisionin për hartimin e rregullores për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve shëndetësorë që humbën jetën në krye të detyrës nga COVID-19, pjesë e së cilës është edhe iniciuesi Oda e Mjekëve të Kosovës.

#### **11.5 Huluntim/Pyetësor rreth vaksinimit të mjekëve**

Vaksinimi për COVID-19 ka filluar në fillim të dhjetorit 2020 dhe që nga 15 shkurt 2021, 175.3 milion doza vaksinash janë administruar. Të paktën 7 vakcina të ndryshme (3 platforma) janë administruar.

OBSH-ja ka nxjerrë një Listë të Përdorimit Emergjent (EUL) për vaksinën Pfizer COVID-19 më 31 dhjetor 2020. Më 15 shkurt 2021, OBSH-ja lëshoi EUL për dy versione të vaksinës AstraZeneca/Oxford COVID-19, prodhuar nga Serum Institute of India dhe SKBio. Deri në qershor 2021, OBSH-ja mund të nxjerrë një listë të përdorimit emergjent edhe për produkte tjera të vaksinave.

Pasi që vaksinat demonstrohen të jenë të sigurta dhe efikase, ato duhet të autorizohen nga rregullatorët kombëtarë, të prodhohen sipas standardeve të kërkuara dhe të shpërndahen. OBSH-ja po punon me partnerë në të gjithë botën për të ndihmuar në koordinimin e hapave kryesorë në këtë proces, përfshirë edhe për të lehtësuar qasjen e barabartë në vaksinat e sigurta dhe efektive COVID-19 për miliarda njerëz që do të kenë nevojë për to.

Oda e Mjekëve të Kosovës ka bërë huluntim rreth akceptueshmërisë të vaksinimit tek mjekët ku qëllimi kryesor i huluntimit ka qenë përcaktimi i nivelit

të mundshëm të pranimit apo refuzimit dhe faktorët që ndikojnë në refuzimin e një vaksine COVID-19.

Në hulumtim janë përfshirë 2273 mjekë nga të tre nivelet shëndetësore, ku nga të gjithë pjesëmarrësit, 94.3% janë përgjigjur që janë të gatshëm ta marrin njërën nga vaksinat e aprovuara.

5.7% kanë dhënë përgjigje refuzuese, ku pjesa më e madhe e tyre apo mbi 50% e tyre si arsye e refuzimit të vaksinimit kanë dhënë “pasigurinë ndaj efekteve anësore”. Pjesa tjetër e mjekëve që kanë refuzuar kanë treguar mosbesim ndaj vaksinave në përgjithësi.

Qytetarët e Kosovës në rrugën e vetme të besimit dhe informimit rreth vaksinimit e kanë Mjekun. Prandaj rezultatet e këtij hulumtimi do duhej të jenë një tregues se popullata nuk ka nevojë të frikësohet apo të jetë skeptike rreth vaksinimit kur vet mjekët i besojnë asaj.

## 11.6 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Me datë 20 mars Oda e Mjekëve të Kosovës ka marrë pjesë në takimin virtual me CPME, ku temë kryesore ka qenë “Kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin”. Gjatë takimit me anëtarë pjesëmarrës u trajtuan tema si ndikimi i rregullores nga EMA dhe ndikimi i rregullores nga ECDC në raport se si të menaxhohet më mirë pandemia, si të jemi të përgatitur për hapat e më tutjeshëm në përmirësim të kujdesit ndaj pacientit.

## 11.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së dhe Prokurori i OMK-së, ka caktuar ekspertë apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën janar-mars	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën janar-mars	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	0	0	1	0	1

## **12. Plani i veprimit për vitin 2021**

### **Projektet afatmesme dhe afatgjata**

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillojë pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i Revistës “Mjeku”, Vëllimi 2
- Organizimi i Kongresit të II vjetor multidisiplinar me fokus onkologjinë
- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar
- Organizimi i Konferencës ndërkombëtare të Bioetikës
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e III-të të OMK-së